

Plani i Punës 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Këshilli Prokurorial i Kosovës



Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

PLANI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Mars, 2025

Përmbajtja:

Përmbledhje e përgjithshme	4
Mandati dhe funksionimi ligjor i Këshillit Prokurorial të Kosovës	5
Misioni	6
Vizioni	6
Vlerat	6
Detyrat dhe kompetencat e Këshillit	6
Përbërja dhe struktura e Këshillit Prokurorial të Kosovës	8
Objektivat e Planit vjetor të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2025	11
I. Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes në sistemin prokurorial	12
a. Avancimi i kornizës nënligjore të sistemit prokurorial	12
b. Fuqizimi dhe reformimi i sistemeve për vlerësimin e performancës, disiplinimin dhe kontrollin e integritetit	12
c. Përmirësimi i llogaridhënies dhe efikasitetit të mbikëqyrjes	12
d. Avancimi i sistemit të rekrutimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve	12
II. Transparenca dhe komunikimi me publikun	13
a. Avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë	13
b. Publikimi proaktiv dhe qasja në dokumentet dhe informacionet e sistemit prokurorial	13
III. Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial	14
a. Menaxhimi i shërbimeve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial	14
b. Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare	14
c. Avancimi i digjitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria)	14
d. Avancimi i infrastrukturës fizike dhe nivelit të sigurisë në sistemin prokurorial	14
e. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit	14
Zbatimi dhe mbikëqyrja e Planit vjetor të punës	15
PLANI I VEPRIMIT I PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS 2025	16

Lista e akronimeve të përdorura

KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës

SKPK – Sekretariati Këshilli Prokurorial i Kosovës

PSH – Prokurori i Shtetit

PS – Prokuroria Speciale

KÇN – Komisioni për Çështje Normative

KBFP – Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel

KVPP – Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve

KAP – Komisioni për Administrimin e Prokurorëve

DPSKPK – Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së

DTI – Departamenti i Teknologjisë Informative

DBF – Departamenti për Buxhet dhe Financa

DBNJ – Departamenti për Burime Njerëzore

DASHP – Departamenti i Administratës dhe Shërbimeve të Përgjithshëm

DL – Departamenti Ligjor

NJKP – Njësia për Komunikim Publik

NJP – Njësia për Prokurim

NJIEMN – Njësia për Integritet Evropian dhe Marrëdhënie

Ndërkombëtare

NJPH – Njësia për Panele Hetimore

AD – Akademia e Drejtësisë

IKAP – Instituti i Kosovës për Administratën Publike

Përmbledhje e përgjithshme

Planin vjetor i punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2025 është hartuar me qëllim të ushtrimit të mandatit ligjor dhe në zbatim të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore dhe kushtetuese.

Plani vjetor i punës për vitin 2025 përmban pjesën hyrëse, në të cilën përshkruhet mandati, përgjegjësitë dhe struktura organizative e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Në këtë plan janë përcaktuar shtyllat dhe objektivat kryesore të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2025, me të cilat synohet fuqizimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyerjes në sistemin prokurorial, transparenca dhe komunikimi me publikun, si dhe sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial.

Plani i punës ka edhe Planin e veprimit, në të cilin janë konkretizuar në formë tabelare aktivitetet, treguesit, bartësit e aktiviteteve dhe afatet kohore për realizimin e objektivave dhe nënobjektivave.

Zbatimi i këtij plani mundëson përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësiwe kushtetuese dhe ligjore të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Mandati dhe funksionimi ligjor i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli është një institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta, me qëllim të sigurimit të një sistemi prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe ligj. Këshilli është themeluar me Ligjin Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2011 dhe aktualisht funksionon bazuar në Ligjin Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ndër parimet bazë të veprimtarisë së Këshillit është të sigurojë që prokuroritë të pasqyrojnë natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës dhe të ndërmarrë masa të nevojshme për të rritur numrin e prokurorëve nga komunitetet joshumicë në Kosovë, në pajtim me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore; të sigurojë që të gjithë personat të kenë qasje të barabartë në drejtësi; të sigurojë që prokuroritë të respektojnë parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë, me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës.

Gjatë ushtrimit të detyrave dhe kompetencave, Këshilli vepron në atë mënyrë që respekton dhe ruan pavarësinë e prokurorëve derisa këta kryejnë funksionet e tyre të ndjekjes. Këshilli nuk do të urdhërojë apo ndikojë, nuk do të përpiqet të ndikojë apo të ndërmarrë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë veprim apo të japë çfarëdo deklarate, e cila në mënyrë të arsyeshme mund të shihet si ndërhyrje apo përpjekje për ndërhyrje në pavarësinë e funksionit të prokurorisë në raport me cilindo person, hetim apo lëndë.

Me qëllim të realizimit të mandatit të Këshillit, me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës janë themeluar trupat e administratës si: Sekretariati i Këshillit dhe Njësi të Shqyrtimit të Performancës së Prokurorisë, që ndihmojnë prokurorët në realizimin e mandatit të tyre kushtetues.

Misioni

Forcimi i sundimit të ligjit, rritja e efikasitetit në luftimin e krimit dhe ngritja e transparencës së sistemit prokurorial dhe qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët.

Vizioni

Një sistem prokurorial i pavarur, efikas dhe etik, që vepron në mënyrë profesionale, llogaridhëse dhe të paanshme, duke siguruar drejtësi të besueshme për qytetarët e Kosovës.

Vlerat

Sistemi prokurorial do të udhëhiqet nga standarde dhe vlera të larta, siç janë:

- Profesionalizmi, integriteti, dinjiteti, etika dhe pavarësia në punë;
- Llogaridhënia dhe transparenca;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së punës dhe përdorimi racional i resurseve dhe
- Efikasiteti dhe efektiviteti në punë.

Detyrat dhe kompetencat e Këshillit

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit janë si në vijim:

- vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të prokurorive sipas ligjit;
- i propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e prokurorëve, si dhe siguron që të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;
- i propozon Presidentit emërimin dhe shkarkimin e Kryeprokurorit të Shtetit, siguron se kandidati i propozuar i plotëson kriteret e përcaktuara me ligj dhe janë zhvilluar procedurat përkatëse;
- vendos për emërimin e kryeprokurorëve të prokurorive themelore, Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë së Apelit, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit dhe Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
- siguron zbatimin dhe mbikëqyrë kriteret për praninë në prokurori, të cilat duhet të bëhen në pajtim me parimet e meritës, mundësive të barabarta, barazisë gjinore, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve;
- bën shpalljen e konkursit publik për prokurorë;
- vendos për organizimin e provimit për kandidatët për prokurorë sipas rregullores së miratuar nga Këshilli për caktimin e numrit të prokurorëve për secilën prokurori;

- vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të prokurorisë përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- vendos për numrin e prokurorëve në secilin prokurori;
- përgatit, dërgon dhe mbikëqyrë buxhetin e Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial;
- vendos për avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve;
- vendos kriteret për vlerësimin e prokurorëve, për ngarkesën me lëndë të prokurorive dhe për funksionim efikas të prokurorive, si dhe kontrollon dhe garanton procesin e vlerësimit dhe shqyrton ankimet e prokurorëve për vlerësimin e tyre;
- vendos dhe mbikëqyrë kriteret për përcaktimin e politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit tjetër dhe mbikëqyrjen e zbatimit të trajnimit dhe zhvillimit profesional të prokurorëve nga Akademia apo shoqata apo organizata e tjera trajnuese;
- miraton Kodin e Etikës Profesionale për anëtarët e Këshillit, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga Këshilli;
- miraton Kodin e Etikës Profesionale për Prokurorë, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione, përfshirë shkarkimin nga funksioni;
- miraton Kodin e Etikës Profesionale për Stafin Administrativ, shqiptimin e masave disiplinore të përcaktuara me Ligjin përkatës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shkelja e të cilit paraqet bazë për sanksione;
- siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve prokuroriale;
- në bashkëpunimin me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politika dhe strategji prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- përgatit një raport vjetor mbi veprimtaritë dhe shpenzimet e Prokurorit të Shtetit dhe të Këshillit;
- mbikëqyrë administrimin e prokurorive dhe personelit të saj;
- mbikëqyrë Sekretariatit, Njësitin për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë dhe nxjerr rregulla dhe rregullore në pajtim me kompetencat e veta;
- përcakton procedurat për seancat dhe zhvillimin e seancave disiplinore;
- bashkëpunon me këshillat prokuroriale të shteteve të tjera dhe organizatat përkatëse vendore dhe ndërkombëtare, me kusht që të mos ndikojë në pavarësinë e punës së tij;
- bën shpalljen e rregullave dhe rregulloreve në pajtim me ligjet mbi informimin publik lidhur me menaxhimin dhe zbulimin e informacionit që mbahet nga Prokurori i Shtetit;
- themelon komisione të cilat Këshilli i vlerëson si të nevojshme;

- miraton rregullat e punës për funksionimin e Këshillit dhe komisioneve të veta dhe për zgjedhjen e atyre anëtarëve të Këshillit që zgjidhen nga kolegët e tyre, rregulla këto, që janë në dispozicion të publikut;
- nxjerr rregullore për procedurën e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit dhe emërimit të kryeprokurorëve të prokurorive;
- nxjerr rregullore për organizimin e brendshëm të Prokurorit të Shtetit;
- garanton një sistemi të hapur dhe të përgjegjshëm të administrimit të vendimeve të Këshillit dhe të Prokurorit të Shtetit;
- raporton para publikut për zbatimin e objektivave të saj, të përcaktuara në mënyrë specifike dhe të bazuar në indikatorë të matshëm;
- miraton aktet nënligjore në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tij, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe
- kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Përbërja dhe struktura e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, dhjetë (10) prej të cilëve janë prokurorë, ndërsa tre (3) anëtarë joprokurorë.

Bazuar në nenin 9 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përbërja e anëtarëve të Këshillit është si vijon:

Dhjetë (10) anëtarë, nga radhët e prokurorëve dhe atë:

- ❖ Kryeprokurori i Shtetit;
- ❖ shtatë (7) anëtarë, prokurorë nga prokuroritë themelore, të përfaqësuar me nga një (1) anëtar, të zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;
- ❖ një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria e Apelit, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;
- ❖ një (1) anëtar, prokuror nga Prokuroria Speciale, i zgjedhur nga prokurorët e asaj prokurorie;

Tre (3) anëtarë joprokurorë, si në vijim:

- ❖ një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- ❖ një (1) anëtar, profesor universitar i drejtësisë;
- ❖ një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat trevjeçar.

Kryesuesi i Këshillit paraqet raporte publike vjetore së paku një herë në vit për performancën, veprimet, koston dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial, si dhe organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundur Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.


Këshilli realizon mandatin e tij përmes punës së komisioneve të përhershme të themeluara me ligj. Këto komisione janë si në vijim:

- ❖ Komisioni për Çështje Normative;
- ❖ Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve;
- ❖ Komisioni për Buxhet Financa dhe Personel dhe
- ❖ Komisioni për Administrimin e Prokurorive.

Disiplinimi i prokurorëve realizohet përmes paneleve të themeluara nga Këshilli, bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057) dhe akteve nënligjore, të themeluara për këtë qëllim.


Këshilli mund të themelojë edhe komisione të përkohshme (*ad hoc*), sipas nevojës.

Sa i përket mbështetjes administrative për sistemin prokurorial, Këshilli e realizon mandatin e tij përmes Sekretariatit kur bëhet fjalë për buxhetin, financat, prokurimin, burimet njerëzore, logjistikën, infrastrukturën, teknologjinë informative, ndërsa aspektet analitike, statistikore, të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe personelit përmes Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.



Shtojca 2

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Objektivat e Planit vjetor të punës së Këshilit Prokurorial të Kosovës për vitin 2025

- I. Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes brenda sistemit prokurorial
- II. Transparenca dhe komunikimi me publikun
- III. Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial

I. Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes në sistemin prokurorial

Llogaridhënia është parakushti kryesor për besimin e publikut në sistemin prokurorial. Për të rritur këtë besim, sistemi prokurorial është i përkushtuar për të forcuar mbikëqyrjen, disiplinën dhe vlerësimet e drejta të performancës. Synimi ynë është të ndërtojmë një sistem prokurorial që respekton standardet e larta etike dhe funksionon me profesionalizëm dhe integritet. Përgjegjësia e kryeprokurorëve dhe udhëheqësve të tjerë brenda sistemit prokurorial është një komponent shumë e rëndësishme për ngritjen e kësaj llogaridhënieje. Udhëheqja transparente dhe e përgjegjshme ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e hetimeve penale, qasjen në drejtësi dhe përdorimin e duhur të burimeve publike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do ta bëjë zbatimin e këtij objekti të përgjithshëm përmes objektivave specifike si më poshtë:

Objektivat specifike:

- a. Avancimi i kornizës nënligjore të sistemit prokurorial;
- b. Fuqizimi dhe reformimi i sistemeve për vlerësimin e performancës, disiplinimin dhe kontrollin e integritetit;
- c. Përmirësimi i llogaridhënies dhe efikasitetit të mbikëqyrjes dhe
- d. Avancimi i sistemit të rekrutimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve

II. Transparenca dhe komunikimi me publikun

Kritja e transparencës së sistemit prokurorial është domosdoshmëri e kohës, me qëllim që të krijohet një lidhje më e fortë me publikun dhe të ndërtimit të besimit të qëndrueshëm në drejtësinë që ne ofrojmë. Publikimi proaktiv, përgjigja në kohë reale ndaj kërkesave për qasje në dokumente të sistemit dhe ngritja e bashkëpunimit me organizatat që monitorojnë punën e sistemit prokurorial janë jetike për forcimin e integritetit institucional, duke synuar një mjedis ku transparenca nuk shihet si detyrim, por si një mundësi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do ta bëjë zbatimin e këtij objekti të përgjithshëm përmes objektivave specifike, si më poshtë:

Objektivat specifike:

- a. Avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë dhe
- b. Publikimi proaktiv dhe qasja në dokumentet dhe informacionet e sistemit prokurorial.

III. Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial

Angazhimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës për të investuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe profesionalizmin e prokurorëve dhe personelit që shërbejnë në sistemin prokurorial, do të jetë një ndër objektivat kryesore për vitin 2025.

Profesionalizmi është thelbësor për trajtimin adekuat të çështjeve, efikasitetin dhe besueshmërinë e tërë sistemit.

Administrimi adekuat dhe ofrimi i shërbimeve të duhura, të nevojshme dhe në kohë janë kyçe për mundësimin e përmbushjes së mandatit kushtetues dhe ligjor të sistemit prokurorial.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do ta bëjë zbatimin e këtij objektiwi të përgjithshëm përmes objektivave specifike si më poshtë:

Objektivat specifike:

- a. Menaxhimi i shërbimeve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial;
- b. Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare;
- c. Avancimi i digjitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria);
- d. Avancimi i infrastrukturës fizike dhe nivelit të sigurisë në sistemin prokurorial dhe
- e. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit.

Zbatimi dhe mbikëqyrja e Planit vjetor të punës

Plani vjetor i punës për vitin 2025 bazohet në mandatin kushtetues dhe ligjor të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe në Planin strategjik të sistemit prokurorial. Realizimi i këtij plani do të bëhet përmes zbatimit të objektivave dhe nënobjektivave, të cilat janë të matshme dhe të arritshme dhe do të realizohen me aktivitete dhe masa konkrete sipas afateve të caktuara.

Plani parasheh vazhdimin edhe të disa aktiviteteve dhe masave, të cilat kanë filluar në vitet paraprake dhe zbatimi i tyre do të vazhdojë edhe këtë vit.

Monitorimi lidhur me zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit vjetor të punës së Këshillit Prokurorial për vitin 2025 do të bazohet në dy periudha raportuese: janar-qershor dhe korrik-dhjetor 2025.

Lidhur me veprimet e ndërmarra nga njësitë përgjegjëse, të cilat dalin nga ky plan i punës është hartuar edhe plani i veprimit, i cili do të përcjellë zbatimin e objektivave, nënobjektivave dhe aktiviteteve të parapara.

PLANI I VEPRIMIT I PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS (2025)

I Forcimi i llogaridhënies, etikës dhe mbikëqyrjes brenda sistemit prokurorial					
Objektivi specifik 1: Avancimi i kornizës nënligjore të sistemit prokurorial					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
1.1.1.	Hartimi i protokolleve për trajtimin e rasteve nga ndikimet e jashtme	KPK	PSH Policia e Kosovës	Janar - dhjetor	Protokollet e hartuara
1.1.2.	Harmonizimi i akteve nënligjore lidhur me performancën, disiplinën dhe kontrollin e integritetit	KÇN	Komisionet e KPK-së Shoqata e Prokurorëve	Janar - dhjetor	Analizat e hartuara
1.1.3.	Memorandume /protokolle në mes të KPK-së dhe AD-së, me qëllim që të sigurohen burimet e informacionit në zbatim të realizimit të vlerësimit të performancës së prokurorëve, të angazhuar në Akademi	KVPP KÇN	AD	Janar - dhjetor	Aktet e miratuara Memorandumet / protokollet e nënshkruara
1.1.4.	Plotësimndryshimi i Kodit të ri të Etikës për zyrtarët e administratës në sistemin prokurorial	Grupi punues	KPK/SKPK	Janar - qershor	Kodi i Etikës për zyrtarët e administratës në sistemin prokurorial, i hartuar

1.1.5.	Hartimi i protokollit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës	KPK	Prokuroria Speciale Policia e Kosovës	Janar-dhjetor	Protokolli i hartuar
1.1.6.	Hartimi i Strategjisë së re për Krimet e Luftës	KPK	PSRK/PSH	Janar-Dhjetor	Hartimi i Strategjisë
1.1.7.	Hartimi i protokolleve për përcaktimin e roleve dhe përgjegjesive nga miratimi deri në publikim të vendimeve të Këshillit	KPK (NJKP)	SKPK	Qershor-dhjetor	Protokollet e hartuara
1.1.8.	Hartimi i akteve nënligjore (shtih Shtojcën I)	KÇN	SKPK, Grupet punuese	Janar-dhjetor	Draftet e akteve nënligjore të hartuara
1.1.9.	Hartimi i udhëzimeve dhe procedurave për rekomandime	KÇN	Grupi punues	Janar-dhjetor	Mekanizmat e krijuar për të mbledhur sugjerime dhe mendime për legjislacionin në fuqi
1.1.10.	Hartimi i rekomandimeve për ndryshime legjislative	KÇN	Grupi punues	Janar-dhjetor	Rekomandimet konkrete
1.1.11.	Hartimi i draftit të Udhëzuesit për Rrjetet Sociale (krijimi i një protokollit të mirëmbajtjes dhe komunikimit me palë të jashtme përmes rrjetit social).	DTI NJKP	Grupi punues DL	Prill-qershor	Udhëzuesi i hartuar
1.1.12.	Hartimi i draftit për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores 03/2019 për Shërbimet e	NJKP	KÇN DL	Tetor-dhjetor	Drafti i hartuar

	Komunikimit me Publikun në Sistemin Prokurorial					
1.1.13.	Hartimi i draftit të PSO-së për përmirësimin e të dhënave gjatë shkëmbimit elektronik prokurori - gjykatë	DTI	Grupi punues i SMIL-it DL	Janar-qershor	Drafti i PSO-së, i hartuar	
Objektivi specifik 2: Fuqizimi dhe reformimi i sistemeve për vlerësimin e performancës, disiplinimin dhe kontrollin e integritetit						
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi	
1.2.1.	Publikimi i raporteve të rregullta të vlerësimit të performancës dhe disiplinës	SKPK-NJKP	Zyra e Kryesuesit të KPK-së KVPP dhe NJPH	Janar-dhjetor	Raportet publikuara	e
1.2.2.	Ofrimi i opinionëve nga Komisioni Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve	Komisioni Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve	Prokurorët e shtetit	Janar-dhjetor	Opinionet e Komisionit të ofruara dhe të publikuara	e
1.2.3.	Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i Raportit përmbledhës të vlerësimit vjetor të performancës së prokurorëve nga eprorët	KVPP KPK	Autoritetet e vlerësimit vjetor të prokurorëve	Janar - mars	Raporti i hartuar dhe miratuar	
1.2.4.	Realizimi i proceseve të vlerësimit të performancës së prokurorëve me mandatin fillestar	KVPP	KPK/SKPK/NJSH PP/DTI/NJKP/NJPH/ZMNV/AD/KKKE	Janar-dhjetor	Raporti i hartuar dhe miratuar	

1.2.5.	Realizimi i proceseve të vlerësimit të performances së prokurorëve me mandat të përhershëm	KVPP	KPK/SKPK/NJSH PP/DTI/NJKP/NJ PH/ ZMNV/AD/KKK E	Janar - dhjetor	Raporti i hartuar dhe i miratuar
1.2.6.	Trajtimi efikas i rasteve disiplinore ndaj prokurorëve	KPK Panellet hetimore	NJPH	Janar- dhjetor	Raportimi në KPK Publikimi i vendimeve
1.2.7.	Zbatimi i sistemit elektronik për menaxhimin e të dhënave për rastet disiplinore ndaj prokurorëve	NJPH	DTI	Janar- dhjetor	Sistemi elektronik i zbatuar
Objektivi specifik 3: Përmirësimi i llogaridhënies dhe efikasitetit të mbikëqyrjes					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
1.3.1.	Raportimi i rregullt i kryeprokurorëve në KPK	KPK	Kryeprokurorët	Janar - dhjetor	Raportet rregullta e
1.3.2.	Avancimi dhe unifikimi i mekanizmit të raportimit të rregullt të kryeprokurorëve në KPK	Grupi punues	KAP	Tetor- dhjetor	Mekanizmi i raportimit i unifikuar
1.3.3.	Monitorimi i zbatimit të akteve të nxjerra nga Këshilli Prokurorial	Komisionet e KPK-së	Kryeprokurorët SKPK	Janar- dhjetor	Raportet vjetore të rregullta të monitorimit
1.3.4.	Raportimi i rregullt i Komisioneve të Përhershme dhe ad hoc të KPK-së	Komisionet e KPK-së	KPK	Janar - dhjetor	Raportet hartuara e

Objektivi specifik 4: Avancimi i sistemit të rekrutimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
1.4.1.	Hartimi i analizës së nevojave për rekrutim të prokurorëve	KAP NJSHP	KPK	Janar-dhjetor	Analiza e hartuar
1.4.2.	Hartimi i analizës së nevojave për transferim dhe avancim të prokurorëve	KAP NJSHP	KPK	Janar-dhjetor	Analiza e hartuar
1.4.3.	Rekrutimi i prokurorëve të rinj	KPK Komisioni për Rekrutim	SKPK NJSHP	Janar-dhjetor	Numri i prokurorëve të rekrutuar
1.4.4.	Zhvillimi i procedurave të transferimit dhe avancimit të prokurorëve	Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve	KPK SKPK NJSHP	Janar-dhjetor	Numri i prokurorëve të transferuar dhe avancuar
1.4.5.	Avancimi i sistemit elektronik për aplikimin online për procedurën e rekrutimit të prokurorëve të rinj	DTI	KPK	Janar-dhjetor	Sistemi i avancuar
II					
Transparenca dhe komunikimi me publikun					
Objektivi specifik 1: Avancimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile, mediat dhe partnerët ndërkombëtarë					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi

2.1.1.	Qasja proaktive për dhënien e informatave në rastet specifike	KPK NJKP	PSH, OJQ, mediat, partnerët ndërkombëtarë	Janar-dhjetor	Informatat e ofruara
2.1.2.	Pjesëmarrja në takime, konferenca dhe aktivitete të përbashkëta	KPK NJKP	PSH, OJQ, mediat, partnerët ndërkombëtarë	Janar-dhjetor	Takimet dhe konferencat e mbajtura
2.1.3.	Mbajtja e fushatave vetëdijësuese dhe sensibilizuese	KPK NJKP	PSH, OJQ, mediat, partnerët ndërkombëtarë	Janar-dhjetor	Fushatat e mbajtura
Objektivi specifik 2: Publikimi proaktiv dhe qasja në dokumente dhe informacione të sistemit prokurorial					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
2.2.1.	Monitorimi i zbatimit të Rregullores për Qasje në Dokumente Publike	KPK	PSH SKPK	Janar - dhjetor	Raporti i monitorimit
2.2.2.	Vlerësimi i zbatimit të vendimeve për qasje në dokumente publike	KPK	PSH SKPK	Janar - dhjetor	Raport për zbatimin e vendimeve
2.2.3.	Përditësimi i të dhënave në portalin e sistemit prokurorial	KPK (NJKP)	PSH SKPK	Janar-dhjetor	Informatat e publikuara
2.2.4.	Funksionalizimi dhe avancimi i uebportalit	NJKP	PSH, operatori ekonomik	Janar-dhjetor	Uebportali i funksionalizuar dhe i avancuar
2.2.5.	Identifikimi i nevojave për avancimin e komunikimit të brendshëm në mbështetje të komunikimit të jashtëm	NJKP	DPSKPK, njësitë organizative në sistemin prokurorial	Janar-dhjetor	Raport për nevojat e identifikuar

2.2.6.	Krijimi i grupit për mbikëqyrjen e zbatimit të Strategjisë për Komunikim në Sistemin Prokurorial 2024-2026	DPSKPK	NJKP	Janar-qershor	Grupi punues i themeluar
2.2.7.	Mbikëqyrja e zbatimit të Strategjisë për Komunikim në Sistemin Prokurorial 2024-2026	Grupi punues	KPK SKPK	Janar - dhjetor	Raportet e hartuara
III	Sigurimi i menaxhimit dhe administrimit adekuat të sistemit prokurorial				
Objektivi specifik 1: Menaxhimi i shërbimeve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
3.1.1.	Mbështetja profesionale dhe administrative për trupat e KPK-së	SKPK	KPK PSH	Janar-dhjetor	Raportet e punës
3.1.2.	Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për burime njerëzore dhe hartimi i Planit të Personelit Administrativ	SKPK	KPK PSH	Janar-dhjetor	Plani i hartuar
3.1.3.	Zhvillimi i proceseve të rekrutimit, avancimit, transferimit, vlerësimit dhe disiplinimit të stafit administrativ në sistemin prokurorial	DBNJ	DPSKPK Njësitë organizative	Janar-dhjetor	Proceset e përfunduara
3.1.4.	Mbështetja në hartimin e akteve nënligjore në kuadër të mandatit të KPK-së dhe PSH-së	DL	SKPK	Janar - dhjetor	Draftet e akteve të hartuara

3.1.5	Përfaqësimi ligjor i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit në kontestet gjyqësore	DL	DPSKPK	Janar-dhjetor	Përfaqësimet në kontestet gjyqësore
3.1.6	Dhënia e opinionëve ligjore, mendimeve profesionale dhe këshillave juridike	DL	KPK, PSH, SKPK, NJSHPP	Janar-dhjetor	Opinionet, mendimet dhe këshillat e ofruara
3.1.7	Hartimi dhe zbatimi i Planit të prokurimit, i bazuar në analizat dhe nevojat për sistemin prokurorial	NJP	KBFP, njësitë kërkuuese, SKPK	Janar-dhjetor	Plani i hartuar
3.1.8	Hartimi i drafteve të planifikimit të masave legjislative dhe zbatuese të sistemit prokurorial në Programin Kombëtar për Integrim Evropian dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesave të mekanizmave ndërkombëtarë	NJIEMN	KPK, DPSKPK ZKM	Tetor-dhjetor	Masat e hartuara
3.1.9	Menaxhimi i proceseve të raportimit të sistemit prokurorial për çështjet e integritetit evropian në trupat e BE-së dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë	NJIEMN	KPK DPS-KPK	Janar-dhjetor	Raportet e dërguara
3.1.10	Mbështetja pe KPK-së dhe trupave të saj në administrimin e proceseve të emërimit, transferimit, avancimit, rekrutimit dhe proceset e verifikimit të prokurorëve	NJSHPP	KPK	Janar-dhjetor	Raportet e punës
3.1.11	Mbështetja e KPK-së dhe PSH-së për analizimin e punës së prokurorëve dhe prokurorive	NJSHPP	KPK	Janar-dhjetor	Raportet e punës

	përmes raporteve analitike dhe raporteve të rregullta periodike				
3.1.12	Mbështetje KPK-së dhe PSH-së në grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave për përgatitjen e raporteve statistikore për punën e prokurorëve dhe prokurorive	NJSHPP	KPK	Janar-dhjetor	Raportet e punës
3.1.13	Auditimi i brendshëm në administratën e sistemit prokurorial	NJAB	Njësitë	Janar - dhjetor	Raporti i auditimit
3.1.14	Sigurimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të brendshme dhe të jashtme	SKPK	Njësitë NJAB Zyra Kombëtare e Auditimit	Janar - dhjetor	Raportet e punës
Objektivi specifik 2: Avancimi i rolit institucional në proceset buxhetore dhe financiare					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
3.2.1.	Përgatitja e KASH-it dhe buxhetit për vitet 2026 – 2028, të bazuara në nevojat, legjislacionin dhe strategjitë e sistemit prokurorial	DBF	KPK/KBFP/PSH	Janar - qershor	KASH-i dhe buxheti, të përgatitura
3.2.2.	Menaxhimi i rrezikut në zbatimin e buxhetit	SKPK	KPK/KBFP/PSH	Çdo 6 muaj	Raportet e punës
3.2.3.	Shqyrtimi i kërkesave të rregullta buxhetore, rishikimit buxhetor dhe kërkesa të veçanta buxhetore gjatë vitit 2025	DBF	KPK/KBFP/PSH	Janar-dhjetor	Kërkesat buxhetore, të plotësuara sipas rekomandimeve

3.2.4.	Shlyerja e obligimeve financiare dhe mbyllja e vitit fiskal konform legjislacionit në fuqi	DBF	SKPK KPK PSH	Janar-dhjetor	Pagesat e ekzekutuara
Objektivi specifik 3: Avancimi i digitalizimit të punës së prokurorisë (e-prokuroria)					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
3.3.1.	Zhvillimi i raporteve statistikore në SMIL	DTI	NJSHPP Grupi punues i SMIL-it	Janar-dhjetor	Raportet e zhvilluara
3.3.2.	Avancimi i SMIL-it	KAP	Grupi punues i SMIL-it DTI	Janar-dhjetor	Sistemi i avancuar
3.3.3.	Monitorimi i zbatimit të raportit përmbledhës - rekomandimet	KAP	Grupi punues i SMIL-it DTI	Janar-dhjetor	Raporti për monitorim, hartuar i
3.3.4.	Ngritja e cilësisë së të dhënave në SMIL	KAP	Grupi punues i SMIL-it DTI	Mars-korrik	Vizitat realizuara në prokurori
3.3.5.	Avancimi i Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Dosjes së Prokurorëve	DTI	NJSHPP	Mars-tetor	Raporti i hartuar i Sistemit i avancuar
3.3.6.	Digitalizimi i arkivave dhe asgjësimi i materialeve regjistratorike	DASHP	SKPK-KPK PSH DTI	Janar-dhjetor	Arkivat digitalizuara Materialet regjistratorike të asgjësuara

Objektivi specifik 4: Avancimi i infrastrukturës fizike dhe nivelit të sigurisë në sistemin prokurorial					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
3.4.1.	Avancimi i nivelit të sigurisë në objektet e sistemit prokurorial	DASHP	SKPK-KPK PSH DTI	Janar-dhjetor	Raportet e hartuara Plani i hartuar
3.4.2.	Hartimi i Draftplanit vjetor të sigurisë në të gjitha objektet e punës	DASHP	SKPK-KPK PSH	Janar-mars	Plani i hartuar
3.4.3. 3.4.4.	Hartimi i Draftplanit të reagimit emergjent	DASHP Grup punues	SKPK KPK	Janar-dhjetor	Plani i hartuar
3.4.5.	Vlerësimi i nevojave për kushte të përshtatshme pune në të gjitha prokuroritë, në KPK dhe njësitë vartëse	KAP	DBFSHP SKPK	Janar-dhjetor	Raportet e hartuara
3.4.6.	Menaxhimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës fizike të sistemit prokurorial	DASHP	SKPK-KPK PSH	Janar-dhjetor	Raportet e punës
Objektivi specifik 5: Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathësie praktike të prokurorëve dhe personelit					
Nr.	Aktivitetet	Përgjegjës	Njësia bashkëpunuese	Afati kohor	Treguesi
3.4.7.	Zhvillimi i kurikulës trajnuese online me Akademinë e Drejtësisë për Kodin e Etikës për Prokurorë	KPK	AD	Dhjetor	Kurikula trajnuese e zhvilluar

	dhe zyrtarët e administratës së sistemit prokurorial				
3.4.8.	Aktivitetet trajnuese obligative për zbatimin e Kodit të Etikës	KPK	AD	Janar-dhjetor	Trajnimet e mbajtura
3.4.9.	Specializime profesionale (LLM) për veprat penale karakteristike	KPK	Partnerët ndërkombëtarë Akademia e Drejtësisë	Janar-dhjetor	Certifikatë/Diplo më
3.4.10	Zhvillimi i kapaciteteve të stafit dhe fuqizimi i procesit të vlerësimit të performancës së stafit administrativ	DBNJ	SKPK	Janar-dhjetor	Raportet e trajnimeve vlerësimet, certifikatat
3.4.11	Zhvillimi profesional dhe trajnimet për prokurorë dhe personelin administrativ të sistemit prokurorial	NJSHPP	AD, SKPK-KPK PSH, IKAP	Janar-dhjetor	Raportet e trajnimit